

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**

**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**ZHVILLIMI I TREGUT TË FONDEVE TË INVESTIMIT NË SHQIPËRI**

**Msc. Alsiva Bazaj<sup>1</sup>**

**MSc. Angjela Nesturi**

**Klaudia Selmanaj**

***Abstrakt***

Grupimi i kapitalit të investitorëve dhe përdorimi i tyre për të blerë letra me vlerë në mënyrë kolektive përbën një fond investimi. Fondi, si alternativë e re investimi, e vendosur në një vend si Shqipëria, ku ende nuk ka një treg kapital të zhvilluar, ka kaluar pritshmëritë e rritjes së tij që prej krijimit, fakt i cili pasqyrohet në rritjen e aseteve nën menaxhimin e fondit si dhe e peshës që ka zënë ky sektor vit pas viti në totalin e subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky punim është një përpyetje për të kuptuar këtë alternativë investimi, kushtet e zhvillimit të saj në mjedisin shqiptar, përparësitë, rreziqet, kostot specifike të investimit në fonde, ecurinë e tij si dhe faktorët ndikues në përcaktimin e çmimit të kuotës. Për Shqipërinë janë realizuar studime mbi performancën, lidhjen e riskut dhe kthimit të fondit të investimit. Ky punim sjell risi pasi nuk është trajtuar më parë për Shqipëri lidhja e faktorëve makroekonomikë në përcaktimin e çmimit të kuotës, e cila përfaqëson përfitimin nga kjo formë investimi.

Duke u bazuar në metodologji empirike, mbështetur në modelet e regresionit të shumëfishtë dhe me të dhënat dytësore me burim nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Fondi i Investimit “Prestigj”, është provuar lidhja e faktorëve makroekonomikë me çmimin e kuotës. Bazuar në arsyetimin ekonomik dhe shumicën e literaturës së fushës, zgjedhja e fondit si mundësi investimi, me pritshmëri të një kthimi të lartë, zë një pjesë të rëndësishme në sistemin financiar. Gjithashtu tregohet një lidhje statistikisht e rëndësishme midis faktorëve makroekonomikë, kryesisht GDP-së me çmimin e kuotës.

***Fjalët kyçe:*** *Fond investimi, analizë empirike, çmim kuote, faktori makroekonomik, portofol.*

---

<sup>1</sup> alsiva.bazaj@hotmail.com